

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Gjatë muajit dhjetor, Bordi i ERE-s ka zhvilluar 9 mbledhje, që kanë rezultuar në 42 vendimmarrje, ndër të cilat:

1.Licencimin e shoqërive:

a. "M.C ENERGJI GOJAN" shpk, "SLR ALBANIA" shpk, "SPV BLUE 2" shpk, "Mountain's Green Energy" shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë; si dhe "VOLTON" shpk në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike;

2.Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërive:

a."MET Albania" sh.a. në veprimtarinë e tregtimit dhe të furnizimit të energjisë elektrike;

b."3AD Energy" shpk dhe "MER Energji" shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike;

c."DESLA" shpk dhe "Sunny Side Energy" shpk në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike;

3.Për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat në një shoqëri:

a.Pranimin e kërkesës së shoqërive "SA-GLE KOMPANI" shpk, "HYDROBORSH" shpk, "PROINFINIT CONSULTING shpk dhe "En.Ku" shpk për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e secilës shoqëri.

Në këtë gazetë do të lexoni mbi

Licencime të muajit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike

Fillime të procedurave për licencim

Zgjatje të afateve vendimmarrëse

Tarifa dhe çmime

Seanca dëgjimore

Aktivitete

Konsultime

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Mbi metodologjitë dhe përcaktimin e tarifave dhe çmimeve për aktivitetet e rregulluara:

- Ndryshimin e pikave 1 dhe 2 të vendimit nr. 206, datë 07.10.2024 e bordit të ERE duke përcaktuar çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Shtator 2024 prej 16.80 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, dhe detyrimin që shoqëria të korrigojë dhe kompensojë diferencat rezultuese të muajit shtator 2024, në faturat e muajit dhjetor.
- Gjithashtu përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin nëntor 2024 prej 21.53 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
- Lënien në fuqi për vitin 2025 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73 datë 13.04.2022 mbi “Miratimin e Tarifave të Shërbimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sipas nivelit të tensionit.”
- Miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, prej 10 Lekë/kWh, për vitin 2025.
- Lënien në fuqi të vendimit nr. 74, datë 13.04.2022, deri më 31.01.2025, për çmimet me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal.
- Lënien në fuqi të vendimit nr. 72, datë 15.04.2024, deri më 31.01.2025, për çmimet e shitjes së energjisë elektrike për klientët e kategorisë “Furra buke/prodhim mielli” të lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV.
- Miratimin e Listës së Tarifave të ALPEX sh.a të cilat do të jenë të aplikueshme për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për vitin 2025.
- Lënien në fuqi të tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a për vitin 2025 prej 28 lek/m³ ose 2.6457 lek/kWh.
- Miratimin e “Metodologjisë për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).
- Miratimin e metodologjisë së përcaktimit të detyrimit për energjinë e rinovueshme.
- Fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e gatishmërisë së tregut shqiptar të energjisë të ditës në avancë.



NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Vendime të tjera si:

- Përfundimin e procedurës së filluar me vendimin e bordit të ERE-s me nr. 79, datë 02.05.2024 “Mbi kërkesën e shoqërisë “FTL” sh.a. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë Dragobia Energy sh.p.k.”
- Pranimin e propozimit të Alpex sha dhe miratimin e Njesisë Kohore të Tregut që i përket orës 00:00 të datës 12.12.2024, si data e fillimit të tregtimit në Tregun e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike.
- Miratimin e kërkesës së ALPEX sh.a., për disa shtesa dhe ndryshime në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike (rregullat e ALPEX- Kushtet e Përgjithshme, Përkufizimet, Procedura e Tregtimit si dhe Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes), të miratuara me vendimin e bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022, i ndryshuar, të cilat mund ti shfletoni në faqen e ERE-s, kategoria vendime.
- d.Pranimin e kërkesës së përbashkët të OST sh.a. dhe ALPEX sh.a., për ndryshimin e afatit të nominimit në tregun e balancimit, përcaktuar në dispozitën 5.5.1.5 të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr.106, date 02.07.2020, e cila tashmë përcakton që nga data 1 mars 2025, nominimet mund të përditësohen brenda ditës, së paku 15 minuta para fillimit të periudhës së lëvrimin.
- Kërkesën e Shoqatës Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) për derogimin e disa dispozitave të “Rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 23/2022, Bordi i ERE vlerësoi zhvillimin e një seance dëgjimore me qëllim përcaktimin e afateve të kohëzgjatjes së aplikueshme.
- Miratimin e “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”.
- Dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC-et e kaskadës së lumit Drin për periudhën 01.10.2023 - 30.09.2024.
- Pranimin e pjesëshëm të kërkesës së FTL sha dhe fillimin e procedurës për shqyrtimin e draft “Marrëveshjes tip për blerjen e energjisë elektrike ndërmjet Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a. dhe Prodhuesve me Përparësi të Energjisë”.
- Miratimin e pjesëshëm të kërkesës së Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e vendimit të bordit të ERE-s nr.186, datë 06.06.2023.

Për tu njohur me këto vendime dhe të tjera, në mënyrë më të detajuar, ju ftojmë të vizitoni faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al në kategorinë [vendime](#).

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Takimit të 38-të i Asamblesë së Përgjithshme të MEDREG

Në datën 5 dhjetor 2024, gjatë takimit të 38-të të Asamblesë së Përgjithshme, nga anëtarët e MEDREG u zgjodh Presidencia e re e shoqates si dhe Kryetarët dhe Nënkryetarët e Grupeve të Punës dhe Task Forcave. Urojmë Presidentin e ri të MEDREG, z.Branislav Prelević kryetar i Regullatorit të Malit të Zi i cili do të udhëheqë Shoqatën gjatë mandatit 2025-2026. Gjithashtu po në këtë Asamble të mbajtur në Bruksel, ndër të tjera, komisionerja e Bordit të ERE znj. Erjola Sadushi, u zgjodh kryetare e grupit të punës së konsumatorit, për të drejtuar punën e këtij grupi të rëndësishëm për 2 vitet e ardhshme; si dhe Sekretari i Përgjithshëm i ERE z. Elton B. Radheshi, u zgjodh lider i Task Forcës për bashkëpunimin të MEDREG me platformën e Unionit për Mesdheut (UfM).



Mbledhja e 59-të e Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë

Në mbledhjen e 59-të të Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë të zhvilluar datë 10 dhjetor 2024 në Athinë, grupet e punës raportuan mbi zhvillimet e sektorit të energjisë elektrike për vitin që po lëmë pas, si dhe u diskutuan dhe miratuan ndër të tjera rregullat dhe procedurat e brendshme të ECRB së bashku me programin e punës për vitin 2025. Gjithashtu në këtë mbledhje u zgjodhën kryetarët e 4 Grupeve të Punës të ECRB, ndër të cilët Sekretari i Përgjithshëm i ERE-s, z. Elton B. Radheshi u rizgjodh kryetar i Grupit të punës së REMIT (Rregullores së integritetit dhe transparencës së tregut të energjisë) dhe do vazhdojë drejtimin e këtij grupi për 2 vitet e ardhshme 2025-2026.



NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Seancë dëgjimore me përfaqësues të Shoqatës së furnizuesve të energjisë elektrike - AEES

Enti Rregullator i Energjisë zhvilloi më datë 19 dhjetor, një seancë dëgjimore në ambjentet e tij, ku ftoi të marrin pjesë përfaqësues të AEES – Shoqata e furnizuesve të energjisë elektrike, si dhe të gjithë furnizuesit që ushtrojnë aktivitetet në treg të lirë, me qëllim diskutimin mes palëve të interesit mbi kërkesën e paraqitur nga AEES për zgjatjen e afatit të derogimit të pjeshëm të dispozitave të “Rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimi me energji elektrike për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit nga klientit” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 23, datë 14.02.2022 i ndryshuar.

Pas diskutimeve palët shprehën qëndrimin e tyre në, në lidhje me kushtin e aplikueshëm të derogimit të implementimit të disa dispozitave të rregullores, për furnizuesit që furnizojnë më pak se 100 klientë fundorë, sic përcaktuar dhe në vendimin në fuqi.

Furnizuesit gjithashtu diskutuan dhe qartësuan detaje teknike mbi përdorimin e Platformës së krahasimit të çmimit të energjisë elektrike - PCT, e cila ka për qëllim rritjen e transparencës për klientët fundorë dhe mbi të cilën mund të shfletoni më shumë në linkun <https://pct.ere.gov.al/aboutPct>.

Seancë dëgjimore në lidhje me shqyrtimin e Aplikimit të shoqërisë OST sh.a. për Tarifën e Transmetimit të Energjisë Elektrike për periudhën regullatore te viteve 2025 - 2027.

Enti Rregullator i Energjisë mirëpriti në datën 6 dhjetor në ambjentet e saj palë interesi, përfaqësues të institucioneve dhe përfaqësues të medias, në një Seancë Publike e cila u realizua në lidhje me shqyrtimin e Aplikimit të shoqërisë OST sh.a. për Tarifën e Transmetimit të Energjisë Elektrike për periudhën regullatore te viteve 2025 - 2027.

Duke qenë së aplikimi i tarifës së operimit të rrjetit të transmetimit është një proces që afekton të gjithë pjesëtarët e tregut dhe në kuadër të zhvillimit të një procesi transparent e jo diskriminues, ERE konsideroi të rëndësishëm përfshirjen aktive të të gjitha palëve të interesit.

Duke patur në fokus mbrotjen e të drejtave të çdo konsumatori dhe përcaktimin e një tarife sa më të saktë dhe transparente u mirëpritën komentet, argumentet dhe pyetjet e paleve pjesmarrëse.

Në vijim ERE në mbledhjen e saj të datës 18.12.2024 miratoi përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 Janar 2025 - 31 Dhjetor 2027, prej 0.85 lekë/kWh.

Gjatë muajit dhjetor janë zhvilluar gjithashtu edhe 8 seanca dëgjimore, me konsumatorë por dhe të licencuar, me qëllim sqarimin e detajeve të nevojshme për zgjidhjen e ankesave përkatëse, apo vazhdimin e procesit të licencimit të subjektit në fjalë, por dhe mbi kërkesa të ardhura nga palë interesi, me qëllim diskutimin dhe shqyrtimin e opinioneve të tyre më gjërë.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Duke shfletuar faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al, mund të njiheni me regjistrat e [licencimit të subjekteve](#), [të garancive të origjinës](#) dhe të [ankesave](#) të perditesuar, si dhe [tarifat dhe çmimet](#) të miratuara nga ERE. Po ashtu në zbatim të Ligjit 43/2015 "Per Sektorin e energjise elektrike", neni 19, gërma k), gjenden te publikuara në faqen e internetit të dhëna [katërmujore](#) për funksionimin e tregut të energjisë elektrike.

Konsultime

ERE në dhjetor ka nisur konsultimin palët e interesit janë të mirëpritura të dërgojnë opinionet e tyre në adresën erealb@ere.gov.al:

- [Metodologjia mbi vlerësimin e gatishmërisë së tregut të ditës në avancë të energjisë elektrike](#)
- [Rregullorja e alokimit të kapacitetit dhe menaxhimit të kongestionit](#)

Gjithashtu ju ftojmë të shfletoni të dhënat e fundit të tregut të energjisë në vend, ku do të gjeni raporte periodike mbi [të dhënat e tregut të energjisë për 10-mujorin e vitit 2024](#).

Po ashtu gjatë muajit dhjetor ERE nëpërmjet mjeteve të komunikimit dixhital (rrjeteve sociale etj) ka njoftuar të gjithë klientët e lidhur në nivelin e tensionin të mesëm, që gjithashtu plotësojnë kriteret ligjore dhe teknike për të dalë në tregun e liberalizuar të furnizimit me energji elektrike, kanë detyrimin të gjejnë furnizuesin e tyre në treg të lirë nga data 1 janar 2025. është sjellë në vëmendje të të gjithë konsumatorëve që i përkasin kësaj kategorie, por edhe çdo konsumatori tjetër që ka plotësuar kriteret për daljen në tregun e lirë të energjisë, që të marrin masat për të gjetur e kontraktuar furnizuesin e tij nga lista e furnizuesve të licencuar nga ERE në këtë veprimtari. Po ashtu janë informuar konsumatorët se në faqen e ERE-s mund të gjejnë të publikuar listën e furnizuesve të licencuar si dhe modalitetet e kontaktimit dhe kontraktimit të tyre.

Në kuadër të këtij njoftimi janë informuar gjithashtu konsumatorët për funksionimin e platformës se krahasimit të çmimeve PCT (Price Comparison Tool), të ndërtuar nga ERE. Duke shfletuar faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al, [mund të njiheni me regjistrat e licencimit të subjekteve](#), [të garancive të origjinës](#) dhe të [ankesave](#) të perditesuar, si dhe [tarifat dhe çmimet](#) të miratuara nga ERE. Po ashtu në zbatim të Ligjit 43/2015 "Per Sektorin e energjise elektrike", neni 19, gërma k), gjenden te publikuara në faqen e internetit të dhëna [katërmujore](#) për funksionimin e tregut të energjisë elektrike.